



*Republika e Shqipërisë*  
*Presidenti i Republikës*

Tiranë, nëntor 2008

**I nderuar Zoti Blois,**

Kujtoj me emocion të veçantë pritjen e ngrohtë, atmosferën festive e vëllazërore që më rezervuat mua dhe delegacionit shqiptar, gjatë vizitës zyrtare në Itali, ndaj dhe përmes kësaj letre dëshiroj t'ju shpreh falenderimet e mia të përzemërta, juve dhe përmes jush, gjithë popullit të Çivitas!

Dëshiroj, me këtë rast, të ritheksoj rolin tejet të rëndësishëm të bashkësisë arbëreshe, e cila me ruajtjen e gjuhës, zakoneve dhe traditave të vendit amë ka kryer mision historik në zhvillimin e marrëdhënieve të lashta historiko-kulturore mes vendeve tona. Shpreh bindjen time në vazhdimësinë e mëtejshme të këtij kontributi, i cili duke nxitur shkëmbimet kulturore, akademike e shkencore, në realitetet e sotme të filozofisë integruese merr rëndësi të veçantë.

Duke Ju falënderuar edhe njëherë për mikpritjen e ngrohtë dhe takimin e përzemërt,

**Bamir Topi**

---

**Zotit Vittorio Blois,**

**Kryetar i Bashkisë së Çivitas**